



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp

Mbi

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 85 % të aksioneve të ARMO Sh.a tek shoqëria e përbashkët ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL Sh.a.

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 26.10.2008 miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 85 % të aksioneve të ARMO Sh.a tek shoqëria e përbashkët ANIKA MERCURIA REFINERY ASSOCIATED OIL Sh.a. (AMRA OIL, Sh.a)

Kontrata e shitjes së 85 % të aksioneve të ARMO, sh.a ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit "AMRA OIL, Sh.a është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9993 datë 18 Shtator 2008 "Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 85 % të aksioneve të ARMO Sh.a ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit, konsorciumit "Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises & Mercuria Energy Group"(AMRA OIL, sh.a). Ky ligj është dekretuar nga Presidenti i Republikës me dekretin Nr. 5901, datë 01 Tetor 2008.

Transaksioni i njoftuar paraqitet si përfitim kontrolli i drejtpërdrejtë, ku shoqëria ARMO Sh.a do kontrollohet nga aksioneri maxhoritar AMRA Sh.a, zotërues i 85% të kapitalit aksionar me të drejtë vote dhe aksioneri METE do të jetë zotërues i 15% të aksioneve.

ARMO sh.a është aktualisht e vetmja ndërmarrje në treg për përpunimin e naftës dhe produktet **Solar, Mazut, Koks, Bitum i lëngshëm, Hollues dhe Virxhinia** të cilat nuk tregtohen nga shoqëritë e tjera që veprojnë në tregun me shumicë dhe/ose pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Për këtë arsye, sjellja e kësaj ndërmarrjeje do të jetë nën monitorim të vazhdueshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për shkak të monopolit (pozitës dominuese) që zotëron në tregjet përkatëse të këtyre produkteve.

Mes shoqërive AMRA Sh.a dhe ARMO Sh.a në mënyrë direkte nuk ka tregje të prekura për shkak se AMRA Sh.a nuk është e pranishme para përqendrimit në tregun shqiptar, por në mënyrë indirekte mund ti konsiderojmë si tregje të

prekura, pasi njëri nga aksionerët, i cili është edhe administratori i AMRA Sh.a zotëron një shoqëri që veprojnë në tregtimin të karburanteve.

Gazoili është i vetmi produkt i prodhuar nga ARMO ku ka tregje të prekura me shoqërinë e njërit prej aksionerëve të palës blerëse. Nga analizat e bëra nga Autoriteti i Konkurrencës, rezulton se shkalla e përqendrimit të tregut rritet pas përqendrimit, por gjithsesi mbetet një treg mesatarisht i përqendruar dhe me konkurrentë të tjerë të fortë me pjesë të konsiderueshme tregu.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të 85 % të kapitalit aksionar të ARMO Sh.a nga AMRA Sh.a, dhe nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të shoqërisë.

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës **vendosi të autorizojë përqendrimin** e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 85 % të kapitalit aksionar të ARMO Sh.a tek shoqëria e përbashkët AMRA Sh.a. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i kërkojë palëve pjesëmarrëse në transaksion që në rast të ndryshimit të titullit të pronësisë mbi aksionet e AMRA - s midis aksionerëve dhe/ose palëve të treta, t'i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës për një vlerësim, përpara realizimit të transaksionit.

www.caa.gov.al
competition@caa.gov.al

tel: +355 4 2234504

fax: +355 4 2234497